

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Ibrahim Idrizi, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesional Zenel Tasholli dhe Musa Kongjeli, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.J. për shkak të veprës penale përvetësimi gjate ushtrimit te detyrës nga neni 340 par.3 lidhur me par.1 te KPK-se, sipas aktakuzës të ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë, PPNr.844-9/2011 të datës 28.06.2012,pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, në prani të prokurorit të shtetit të akuzuarit dhe mbrojtësit, avokat A.I., më datë 23 shtator 2016 shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërkaq më datë 4 tetor 2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.J., data e lindjes....., më vendbanim në fshatin, Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i pesë fëmijëve, me gjendje te mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin e inxhinierisë, i pa punë, pensioner, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri,

Ë s h t ë F a j t o r

I.

Se me datë 30.08.1999 me servisin “” , ka lidhur kontratën me numër 2831 SUBC – S – 320432, në vlerë prej 135.000 marka gjermane dhe sipas faturës nr.216/99 të dates 10.11.1999, shuma prej 135.000 DM është faturuar me avansin e paguar në shumë prej 96.500 DM e cila shumë nuk është hyrë në arkën ditore si dhe në librin e faturave dalëse dhe sipas faturës nr. 216/99 ka pranuar nga kontraktuesi “” shumën prej 38.500 DM të cilën shumë e ka dorëzuar në arkën e ndërmarrjes “” në bazë të urdhërit të arkës nr.75/99 - 104/99 të dates 18.11.199, duke përvetësuar kështu shumën prej 96.500 DM (shëndrruar në

euro 49.339, 67 euro), me që rast të dëmtuarës Agjencisë Kosovare të Privatizimit i ka shkaktuar dëm për këtë shumë të parave,

-me këtë kreu veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare nga neni 340 par 3 lidhur me par.1 të KPK-së,

Andaj gjykata ne bazë të neneve 2, 3, 6, 11, 15, 34, 36, 42, 43, 64, 340 par.3 e 1 të KPK-së si dhe të nenit 365 te KPPKsë,

E GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2/dy/vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i akuzuari në afat prej dy viteve , pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimit).

Obligohet që palës së dëmtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit të i paguaj shumën prej 49.339,67 euro për dëmin e shkaktuar me veprën penale.

Obligohet që Gjykatës të ia paguaj shumën prej 750/shtatëqind e pesëdhjetë/ euro në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe për paushallin gjyqësor shumën prej nga 150/njëqind e pesëdhjetë/euro në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II.

Në bazë të nenin 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së,

REFOZOHET AKUZA

1.Se prej datës 01.07.1999 deri më 31.12.1999, ka paraqitur në kontabilitet fatura të rrejshme për furnizimin me repromaterial -llamarinë të plastifikuar, nga importi prej Republikës së Maqedonisë nga firmat “.....” me numër kontimi 127/4320, në vlerë prej 29. 492 , DM dhe nga firma “” , me numër kontimi 56/4320, në vlerë prej 221.035 DM, me çka ka përvetësuar shumën e përgjithshme 250.527 DM,

- me çka ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK- së,

2.Se më datë 08.03.2002 ka keqpërdor shumën e parave në vlerë prej 23.324 euro, mjete të cilat janë siguruar në emër të qirasë për muajin shkurt nga AP – ja , mjete të cilat janë rexhistruar si hyrje në ditarin e arkës Nr.26 , nga faturat nr.127/2002 ne vlerë prej 13.372 euro dhe nr.128 /2002 te datës 06.03.2002, në vlerë prej 12.868 euro dhe këto mjete nuk janë shfrytëzuar për nevojat e ndërmarrjet por janë përvetësuar nga i akuzuari.

- me çka ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK- së,

3.Se më datë 13.12.2002 ka keqpërdor mjetet në shumë prej 45.619 euro sipas faturës nr.1110 / 02 të datës 13.12.2002, mjete të cilat gjoja se janë dedikuar për ndërmarrjen “” për kryerjen e punëve, punë të cilat nuk janë kryer dhe këto mjete janë përvetësuar nga i akuzuari.

- me çka ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK- së,

Me që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor për pjesën refuzuese bien në barrë të mjeteve buxhetore.

E dëmtuara AKP për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

1.Historiku i procedurës dhe aktakuza

Ish Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PPNr.844-9/2011 të datës 28.06.2012,ndaj të akuzuarit N.J., për shkak të katër veprave penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK- së,

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuzë, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore me datë 26.02.2014,10.06.2014,18.06.2014,09.10.2014,25.01.2016,13.04.2016,08.07.2015,25.08.2016, 22.09.2016 dhe 23.09.2016.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, në fazën e ndryshimit të akuzës është tërhequr nga akuza dhe nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit për veprat penale të përshkruara në pikën 1, 3 dhe 4 të akuzës fillestare, ndërkaq ka ndryshuar kualifikimin juridik për veprën penale të përshkruar në pikën 2 të aktakuzës fillestare dhe të akuzuarin për këtë pikë e ka akuzuar për veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.1 lidhur me par.3 të KPK-së.

Në fjalët përfundimtare të palëve i ka propozuar gjykatës, që të akuzuarin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 340 par.1 lidhur me par.3 të KPK-së, me që me provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, provat materiale përfshirë edhe ekspertizat e ekspertëve financiar.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar AKP-ës, i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka paraqitur kërkesë pasurore juridike në vlerë të dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale nga i akuzuari dhe atë në shumë 49.339,67 euro.

2 Mbrojtja e të akuzuarit N.J.

I akuzuari N.J., nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzën e ndryshuar të prokurorit të shtetit.

Në mbrojtjen e tij të dhëne në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në firmën “..... “ është emëruar drejtor në muajin korrik 1999 kjo firmë ka filluar edhe punën, janë formuar organet si: këshilli punëdrejtues i përbër prej të gjithë udhëheqësve të reparteve, kurse në vitin 2000 është formuar këshilli i punëtorëve dhe organet e ndërmarrjes si tubimi i punëtorëve dhe kontrolla interne.

Kjo ndërmarrje ka kryer punë me porosi, që kanë të bëjnë me metalin, rregullimet e kulmeve të objekteve prej metali, saldimet, rezervat të derivateve të naftës etj, se lëndën e parë e kanë siguruar nga Maqedonia dhe nga tregu vendor, pagesa për lëndën e porositur

është kryer me para të gatshme dhe materialin e ka pranuar depoisti por nganjëherë edhe në vendin ku janë kryer punimet.

Në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të gjitha dokumentet për pranimin dhe pagesën e mallit kanë ekzistuar te depoisti dhe në shërbimin financiar, por dokumentet e tilla a janë ruajtur më pastaj për këtë nuk ka njohuri.

Më datë 30.08.1999 është lidhur një kontratë me ndërmarrjen “” me të cilën “.....” ka kryer punët për rregullimin e kulmeve në ndërtesën e Ish “” në Ferizaj, këtë kontratë e ka nënshkruar i akuzuari në pozitën e drejtorit gjeneral të ndërmarrjes “” dhe vlera e kryerjes së punëve sipas kësaj kontrate ishte 135.000 marka gjermane. Lëndën e parë e kanë siguruar nga një firmë në Maqedoni, me pagesë në dorë, ndërkaq kontraktuesi “” ka paguar avans dhe kur janë kryer punët në tërësi është paguar çmimi sipas kontratës.

Për këtë kontratë ka ekzistuar edhe dokumentacioni komplet si fletëporositë për materialin e porositur, fletëpagesat – faturat dalëse dhe të tëra dokumente tjera.

Në vitin 2005 kontrolla interne e ndërmarrjes ka përpiluar një raport rreth dyshimeve për keqpërdorime në këtë ndërmarrje, raporti i tillë është prezantuar në këshillin e punëtorëve dhe në tubimin e punëtorëve nuk është aprovuar. Më tutje në mbrojtjen e tij ka deklaruar se dëftesën me numër 105/99 të datës 18.11.1999, e ka nënshkruar në pozitë të drejtorit, kjo dëftesë i referohet shumës prej 38.500 DM të inkasuara nga firma “” , ndërkaq kjo firmë avansin në shumë prej 96.500 DM e ka paguar me datë 30.08.1999 të cilën shumë e ka pranuar i akuzuari. Me përfundimin e vitit 1999 nuk është përpiluar ndonjë raport nga ana e komisionit të kontrollës interne me që ky komision nuk ishte i formuar, por këshilli pune drejtues gjatë vitit 1999 ka përgatitur bilancin për këtë vit por një bilanc – raport i tillë nuk është shqyrtuar para ndonjë organi të ndërmarrjes që ishin të formuara në vitin 1999.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.J. av. A.I., në fjalët përfundimtare të palëve ka propozuar që i akuzuari të lirohet nga akuza në mungesë të provave. Ka deklaruar se në asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me akuzën e ndryshuar të prokurorit. I akuzuari në pozitë të drejtorit në ndërmarrjen “” i ka nënshkruar kontratat me vlera të larta, se vetëm drejtori financiar dhe zëvendës drejtori kanë pasur të drejtë të nënshkruajnë faturat dhe urdhërpagesat, kurse i akuzuari nuk e ka mbajtur në posedim vulën e organizatës.

Nuk qëndron fakti se i akuzuari të ketë përvetësuar shumën prej 49.339,67 euro kur me servisën “.....” ka lidhur kontratë dhe ka pranuar shumën prej 38.000 DM, me që shuma tjetër nga shuma e përgjithshme e kontratës, e pranuar avans është përdoruar për pagesën e mallit të porositur nga një firmë e Maqedonisë, me para të gatshme me që në atë kohë nuk kishte funksionuar sistemi bankar dhe nuk janë siguruar provat materiale si dhe mungon dokumentacioni në sektorin ekonomik financiar përkitazi me avansin e paguar nga kontraktuesi dhe të përdorur për pagesën e materialit, e që kjo nuk nënkupton përvetësimin me qëllim që vetit ti sjellë dobi të kundërligjshme pasurore.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor, gjykata ka paraqitur dhe vlerësuar të gjitha provat e çështjes penale në bazë të të cilave vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv, të cilën gjendje faktike e vërtetoi dhe e bazoi në këto prova:

- nga dëshmitë e dëshmitarëve Q.Q., H.H., R.P., H.A. në shqyrtim gjyqësor,
- raporti i kontrollës interne i dt.27.04.2005,
- fatura me nr. kontimi 127/4320, 56/4320, 216/99,
- kontrata nr.2831 SUBC – S- 320432, ditari i arkës nr.26, fatura nr.105/99 te dt.18.11.1999, fatura nr.127/2002, 128/2002, 1110/02 te dt.13.12.2002,
- Ekspertiza financiare e ekspertit financiar F.T. e dt.10.05.2012,
- Ekspertiza financiare e ekspertit financiar Sh.B.,
- Ekspertiza financiare e eksperteve gjyqësor A.B., A.G. dhe Sh.M..

4. Përmbledhje e dëshmive të dëshmitarëve

Dëshmitari Q.Q. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në organizatën “ “ prej vitit 1999-2006 ka punuar drejtor i sektorit kadrovik, drejtor gjeneral ka qenë N.J., në ndërmartje ka ekzistuar shërbimi komercial, kurse në vitin 2005 në prokurori është dorëzuar dokumentacioni komplet për dyshimet rreth keqpërdorimeve nga ana e të akuzuarit N.J., pasi që është formuar një komision i brendshëm dhe pas kontrollimit të dokumentacionit ka përpiluar raportin me shkrim.

Në ndërmarrje ka ekzistuar bordi i drejtorëve dhe këshilli i punëtorëve që kanë nxjerrë vendime të rëndësishme për ndërmarrjes, kurse gjatë vitit 1999 – 2002 ka qenë e formuar kontrolla interne e ndërmarrjes që është marrë me shkeljet financiare, ekonomike e të tjera dhe i ka raportuar drejtorit të përgjithshëm dhe këshillit të punëtorëve, dëshmitari si drejtor i sektorit juridik ka mbajtur dy lloje të vulave të ndërmarrjes dhe atë një të katrore dhe tjetra e rrumbullakët e që pas një kohe vulën e rrumbullakët e ka marrë në posedim drejtori tani i akuzuari N.J. pa përpiluar procesverbal.

Dëshmitari H.H. ka deklaruar se ka punuar në “ “ prej muajit shkurt 2002 deri në muajin qershor 2003 në pozitën drejtor i sektorit ekonomik dhe në përgjithësi ka sqaruar progreset e ndërmarrjes duke deklaruar se të gjitha shërbimet kanë pas një avansim me që ishte në konsolidim edhe sistemi bankar, dhe në kuadrin e ndërmarrjes ka qenë edhe arkëtari.

Dëshmitari R.P. ka deklaruar se në vitin 1999 ka filluar punën në muajt korrik- gusht në ndërmarrjen “.....” shef i prodhimit, ka paraqitur nevojat për material, ka organizuar prodhimin dhe se lëndën e parë e kanë siguruar shumicën prej Maqedonisë.

Dëshmitari H.A. ka deklaruar se në muajin shtator 1999 ka filluar punën në ndërmarrjen “” – depoist kryesor, ka udhëhequr dhe ka përcjellë materialin sipas porosive të udhëheqësit prodhimit dhe të gjitha faturat dhe dokumentet ka deklaruar se i ka ruajtur në mënyrë precize.

Dëshmitari H.R. ka deklaruar se në ndërmarrjen “” në pozitën e drejtorit teknik ka punuar prej muajit korrik 1999 deri në vitin 2005. Këshilli drejtues ka formuar një komision të kontrollës interne dhe kryetar i këtij komisioni ka qenë dëshmitari, për të vërtetuar dokumentet në sektorin ekonomik si faturat hyrëse, dalëse – shitjet e prodhimit të ndërmarrjes dhe është përpiluar një raport pasi janë kontrolluar dokumentet nga sektori ekonomik – financiar, janë evidentuar të gjitha të gjeturat në këtë raport që në bazë të të gjeturave ky raport ka konstatuar një gjendje reale.

5. Analizë e dëshmime të dëshmitarëve, vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe të gjeturat faktike të gjykatës

Gjykata shqyrtoi të gjitha provat në shqyrtimin gjyqësor, i vlerësoi një nga një dhe në ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPPK-së, dhe konstatoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata fillimisht vlerësoi si të pa kontestuara këtë fakte: se i akuzuari prej muajit korrik të vitit 1999 ishte në pozitën e drejtorit gjeneral në NSH “.....” në Ferizaj, po ashtu në bazë të kësaj pozite ka nënshkruar edhe kontratat për kryerjen e punëve për ndërmarrjet tjera siç ka ndodhë edhe me ndërmarrjen – servisin” kur ka nënshkruar kontratën me numër 2831 SUBC – S – 320432 në vlerë të përgjithshme prej 135. 000 DM, po ashtu nuk është kontestuar edhe fakti se sipas faturës 216/99 i akuzuari nga kjo ndërmarrje ka pranuar shumën prej 38.500 DM, por kontestuese ishte fakti se diferenca prej shumës të pranuar nga i akuzuari pra 38.500 DM nga shuma e përgjithshme prej 135.000DM, cilit person i është dorëzuar, a është evidentuar kjo shumë në faturat dhe ditarët e ndërmarrjes , a është dorëzuar në arkë të ndërmarrjes dhe se çfarë prova ekzistojnë lidhur me këtë fakt.

Për të konstatuar gjendjen faktike gjykata fillimisht ka siguruar ekspertizën e ekspertit financiar F.T. të datës 07.05.2012i cili e ka konstatuar se me datë 30.08.1999 është lidhur kontrata në vlerë prej 135.000 DM dhe sipas faturës nr.2016/99 është pranuar shuma prej 38.500 DM kurse shuma tjetër prej 96.500 DM është përvetësuar pa ndonjë bazë apo dëshmi për këtë shumë pra për këtë shumë nuk ka mbulesë se këtë para a kanë hyrë në arkë, me që për periudhën e vitit 1999 për mungesë të sistemit bankar të gjitha pagesat janë kryer përmes arkës, e që kanë nënkuptuar se ka qenë dashur që të evidentohen me fatura dhe të rexhistrohen në kartelat e obligimit.

Gjykata ka urdhëruar edhe ekspertizën tjetër nga eksperti Sh.B. i cili në ekspertizën e datës 19.05.2014 sa i përket kontratës me numër 2831 të datës 30.08.1999 ka konstatuar se parashihet edhe koha e implementimit të kontratës e paraparë deri më 32.09.1999 e që nga nënshkrimi i kontratës dhe deri te përgatitja e faturës nr.216/99 ka qenë një periudhë prej më shumë se 3 muaj e që del jashtë elementeve të parapara në kontratë sa i përket afatit të implementimit. Eksperti më tutje konstaton se me datë 10.11.1999 janë paraqitur dy fatura me nr. 216/99 që i referohen kontratës SUBC – S 320432, fatura e parë paraqet pagesën prej 70 % të kontratës – shumën prej 96.500 DM por i mungon ose nuk mund të dallohet nënshkrimi i faturistit dhe vlera e kësaj fature është e përmirësuar por është e vulosur dhe nënshkruar nga drejtori dhe në mungesë të faturës origjinale është e pamundur të dihet se kur është bërë ky përmirësim, ndërkaq po ashtu me datë 10.11.1999 është fatura me numër

2016/99 SUBC- S 320432 në vlerë prej 38.500 DM dhe urdhër i arkës nr.78/99, dëftesa nr.105/99 për faturën 2016/99, ditari i arkës për inkasimin nga kjo faturë, ky konstatim i tillë i ekspertit është i bazuar në materialet e ofruara dhe atë raporti i kontrollës interne, raporti i hetuesisë, faturat, dëftesat, raportet e arkës, urdhër inkasimet dhe kontrata të cilat kanë qenë pjesë e shkresave të lëndës por që eksperti ka konkluduar se për dhënien e mendimit të plotë sa a ka patur mungesë – shpërdorim ka qenë dashur të sigurohen edhe provat e tjera siç janë libri komplet i inkasimeve, dëftesat – ditari ditor i arkës për muajin nëntor –dhjetor 1999.

Nga ekspertiza e përbashkët e ekspertëve financiar A.B., A.G. dhe Sh.M. e datës 08.06.2016 është konstatuar se me datë 30.08.1999 NSH “.....” me servisin” ka lidhur kontratën nr.2831 SUBC-S320432, në të cilën është paraparë periudha e implementimit të kontratës për periudhën prej 30.08 deri më 30.09.1999, në vlerë të përgjithshme prej 135.000 DM dhe nuk ka pas vërejtje me shkrim nga kontraktuesit që do të kishte nënkuptuar se implementimi i kontratës ka përfunduar në afatin e kontraktuar, po që pagesa e çmimit të kontratës është kryer pas 40 ditësh pas implementimit të kontratës, e që ekspertët kanë theksuar se në dosje gjenden dokumentet si kontrata, fatura e datës 10.11.1999 nr. 216 /99 SUBC-S320432, në shumë prej 135.000 DM, nga e cila shumë është zbritur avansi i paguar 70% i shumës totale, që është shuma e paguar prej 96. 500 DM, fatura e datës 10.11.1999 nr. 216 /99 SUBC-S320432, në shumë prej 38.500 DM, dëftesa nr.105 /99 e datës 18.11.1999 me të cilën dëshmohet se shuma prej 38.500 DM i është dorëzuar arkëtarit të ndërmarrjes nga drejtori – N.J., me përshkrim se janë mjete nga kontraktuesi “” , por pa ndonjë dokument se kjo shumë e parave është tërhequr nga kontrakti, urdhër arke – inkasomi nr. 78/99 dt. 18.11.1999 ku është bërë inkasimi i mjeteve sipas faturës nr. 216/99 nga” në shumë prej 38.500 DM, ditari i arkës dt. 18.11.1999 – hyrje nga inkasomi i faturës nr.2016/1999 nga” në shumë prej 38.500 DM.

Ekspertët kanë konstatuar se personi i autorizuar për nënshkrimin e kontratës dhe në dokumentet që ka pranuar pagesën nga”, ishte drejtori i ndërmarrjes “” N.J. dhe se nga dokumentacioni, nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe nga deklaratat e vet të pandehurit nuk është cekur se kontraktuesi” nuk i ka kryer obligimet e tërësishme sipas kontratës, nuk ekziston ndonjë shkresë dërguar kontraktuesit për mos pagesën e shumës prej 96.500 DM dhe shuma e pranuar avans nga ana e drejtorit nuk ka provë se kjo shumë është dorëzuar në arkën e ndërmarrjes “ “ , avansi nuk mund të zbritet nga fatura pa pagimin e tij, për të konstatuar se janë dy fatura të njëjta me datë të njëjtë të nënshkruara nga drejtori por me shuma të ndryshme sipas njëres faturë drejtori N.J. në arkën e ndërmarrjes ka dorëzuar

shumën prej 38.500 DM, pas zbritjes të avansit në shumë prej 96.500 DM, e të cilin avans – shumë nuk e ka dorëzuar në arkën e ndërmarrjes “ “.

Gjykata vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve duke konstatuar se nuk kishte kontestuese fakti se i akuzuari N.J. në pozitën e drejtorit të ndërmarrjes “ “ kishte autorizime për lidhjen e kontratave në shuma më të larta, se në vitin 1999 pagesat për materialin e porositur si lëndë e parë janë kryer me para në dorë – kesh, po ashtu në vitin 1999 në këtë ndërmarrje ishte formuar kontrolla interne dhe se vulat e ndërmarrjes ishin në posedim të drejtorit.

Në vitin 2005 është formuar komisioni i brendshëm i kontrollës me që kishte dyshime rreth keqpërdorimeve në këtë ndërmarrje nga ana e drejtorit dhe se komisioni i formuar ka kontrolluar dokumentacionin dhe ka përpiluar raportin me shkrim për gjetjet reale.

Trupi gjykues këto dëshmi i ndërlidhi me provat materiale dhe ekspertizat e kryera, me mbrojtjen e të akuzuarit për të konstatuar se provat e tilla konstatuan gjendjen reale sa i përket veprimeve të të akuzuarit N.J., i cili nuk e ka mohuar faktin se e ka nënshkruar kontratën nr. 216 /99 SUBC-S320432, në shumë prej 135.000 DM, nga e cila është zbritur avansi 70% - fatura e arkës e datës së njëjtë në shumë prej 38.500 DM, dëftesa nr.105/99 të datës 18.11.1999 nga e cila konstatohet se në arkën e ndërmarrjes është dorëzuar shuma prej 38.500 DM nga i akuzuari, ndërkaq shuma prej 96.500 DM nuk është dorëzuar në arkë e kur këtyre fakteve u shtohen edhe provat siç është raporti i kontrollës interne nr. 124 i datës 27.04.2005 në të cilin është konstatuar se sipas kontratës të datë 30.08.1999 është paguar shuma prej 96.500 DM nga kontraktuesi “.....” – avans , në bazë të faturës 216/99 dt.10.11.1999 dhe kjo shumë nuk është hyrë në arkën ditore si dhe nuk është rexhistruar në librin e faturave dalëse , por është inkasuar shuma prej 38.500 DM sipas urdhërit të arkës nr.75/99 dhe 104/99 të datës 18.11.1999.

Konstatimet nga raporti i kontrollës interne lidhur me te gjeturat reale – faktike në ndërmarrjen “ “ është në harmoni me konstatimet e ekspertëve financiar F.T. dhe grupit të ekspertëve, A.B., A.G. dhe Sh.M..

Nga të gjitha këto fakte dhe argumente, trupi gjykues konstatoi se i akuzuari N.J. në cilësinë e personit zyrtar – Drejtor i ndërmarrjes “ “ gjatë kryerjes së detyrës ka përvetësuar shumën prej 96.500 DM të konvertuar në euro 49.339,67 euro me që siç u cek në pjesën e të gjeturave faktike shuma totale e kontratës është inkasuar nga kontraktuesi “.....”, e

pranuar nga i akuzuari, shuma prej 38.500 DM është dorëzuar nga i akuzuari në arkën e ndërmarrjes “i”, por jo edhe shuma prej 96.500 DM e pranuar si avans nga kontraktuesi “” .

6.Kualifikimi juridik i veprës penale

Trupi gjykues konstatoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.3 i KPK-së, për të cilën vepër është fajtor dhe penalisht përgjegjës pasi që u vërtetua me të gjitha provat se i akuzuari ka përvetësuar shumën prej 96.500 DM, me që në kuadër të autorizimeve ka pas të drejta të caktuara si drejtor i përgjithshëm i ndërmarrjes “”, në çasjen e pranimi të pagesave dhe disponimit me këtë mjete, që po ashtu u vërtetua se parat i ka pranuar nga kontraktuesi, një shumë të caktuar e ka dorëzuar në arkën e ndërmarrjes, ndërkaq pjesën tjetër nuk e ka dorëzuar në arkë dhe nuk e ka provuar – argumentuar dorëzimin e kësaj pjese të parave, për ndonjë pagesë për lëndën e parë të siguruar për ndërmarrjen “”, me që të gjitha faturat hyrëse dhe dalëse për shumën e paguara nga ndërmarrjet tjera dhe shumën që ka pranuar ndërmarrja “” janë rexhistruar në ditarët e arkës , ndërkaq shuma prej 96.500 DM nuk është evidentuar si pagesë dalëse nga ndërmarrja “” .

7.Përcaktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 64 i KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin , gjeti se nuk është i njohur si kryes i veprave penale të llojit të tillë apo të llojit tjetër, është i moshës relativisht të shtyrë, se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë mjaft e gjatë, por edhe përkundër këtyre rrethanave gjykata ka gjetur se ekzistojnë edhe rrethanat rënduese sepse i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar ka keqpërdorur pozitën zyrtare duke përfituar – përvetësuar shumën prej 49.339,67 euro, mënyra e kryerjes së veprës penale – si person zyrtar duke disponuar me parat të cilat janë besuar, e që një shumë të caktuar (e cekur si në dispozitiv) nuk e ka dorëzuar në arkën e ndërmarrjes dhe në përgjithësi duke destabilizuar ekonominë e ndërmarrjes dhe më gjerë.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me burgim të kushtëzuar është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe

se me dënimin e tillë do të arrihet qëllimi i paraparë në nenin 34 të KPK-se, se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që në të ardhmen i akuzuari mos të kryej vepra të tilla dhe të tjera penale – si preventivë speciale dhe njëherit do të ndikoj të personat e tjerë në parandalimin e kryerjes së veprave të tilla penale – preventiva gjenerale.

8. Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 450 e 453 të KPPK-së që përfshijnë shpenzimet e ekspertëve për kryerjen e ekspertizave ndërkaq shuma paushallë duke marrë parasysh ndërlikueshmërin e procedurës dhe gjendjen ekonomike – financiare të të akzuarit

Vendimi për kërkesën pasurore juridike është i bazuar në nenin 463 të KPPK-së.

Nga të cekurat me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PNr.617/12
Më datë 4 tetor 2016

Sekretare juridike
Albana Ajvazi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Ibrahim IDRIZI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.